

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Наставна програма

АЛБАНСКИ ЈАЗИК (ИЗБОРЕН ПРЕДМЕТ)

за VI одделение

Programi mësimor

GJUHË SHQIPE (LËNDË ZGJEDHORE)

për klasën VI

Скопје, Shkup, 2023

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Gjuhë shqipe
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	Lëndë zgjedhore
Klasa	VI (e gjashtë)
Tema/fusha programore	<ul style="list-style-type: none"> • Unë, familja ime dhe miqtë e mi • Shkolla dhe mjedisi jetësor • Koha e lirë dhe pushimet
Numri i orëve	2 orë në javë / 72 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • kompjuter, printer, projektor, tabelë, afishe (postera); • fotografi, ilustrime me figura, sende të nevojshme, letra ngjitëse; • material për të bërë kartolina për ditëlindje: letër, gërshtë, letër me ngjyra, ngjitës, blloqe, plastelinë, ngjyra druri, markerë.
Normativi për kuadrin mësimor	<p>Mësimdhënjen e lëndës së gjuhës shqipe si lëndë zgjedhore në klasën e VI të arsimit fillor nëntëvjeçar mund ta realizojë personi i cili ka kryer drejtimin arsimor të programeve studimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi* <p><i>* Sipas Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme, Neni 10, paragrafi (3): “Kur në shpalljen publike nga paragrafi (1) i këtij neni, do të paraqiten më shumë kandidatë, përparësi u jepet mësimdhënësve që kanë shkallë më të lartë të arsimit të lartë përkatës dhe sukses më të lartë gjatë studimeve deridiplomike”.</i></p>

NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit që përmenden në programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën **Përdorimi i gjuhëve të tjera.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
II-A.1	të kuptojë fjalitë dhe frazat që përdoren shpesh dhe që kanë të bëjnë me fusha të afërta me rëndësi personale (të tilla, si informacione personale dhe familjare, nevoja dhe interesa të ndryshme);
II-A.2	të nxjerrë porosinë kryesore nga mesazhet e thjeshta e të qarta, nga njoftimet, nga udhëzimet nga lutjet etj.;
II-A.4	të gjejë informacione konkrete në tekste reale të ndryshme (p.sh. në reklama, në plane, në udhëzime, në broshura, në lista ushqimesh, në orare udhëtimesh etj.) dhe të kuptojë mesazhe të shkurtra të thjeshta, për të menaxhuar situatat e përditshme;
II-A.6	të shqiptojë qartë dhe saktë të gjithë tingujt dhe grupet e tingujve, duke respektuar rregullat e theksit dhe intonacionit, ndërkohë që parregullsitë e mundshme të mos e pengojnë komunikimin;
II-A.7	të përdorë shprehje të zakonshme dhe fjali që përdoren gjatë përvojës së drejtpërdrejtë dhe/ose u referohen temave dhe situatave me interes të drejtpërdrejtë;
II-A.8	të shkruajë fjalë dhe shprehje me saktësi relative, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	të mësuarit e një gjuhe tjetër lehtëson mësimin e shumë gjuhëve dhe mundësinë e komunikimit me anëtarë të grupeve të ndryshme kulturore/gjuhësore;
I-B.3	përmes të mësuarit të gjuhëve të tjera zhvillohet interesi dhe respekti për gjuhët dhe kulturat e ndryshme.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të këtyre fushave të Standardeve nacionale: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike dhe Të shprehurit artistik dhe kultura.**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimin e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;

V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
VI-A.3	t'i formulojë e t'i argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë me vëmendje e t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të sillet me respekt ndaj tyre, madje edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet mes njerëzve në bazë të cilësdo përkatësie (gjinore, etnike, të moshës, të aftësive, të statusit social etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjytimeve të vetja e të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore.
<i>Nxënësi /nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerr është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;

V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.
-------	--

REZULTATET E TË NXËNIT

Tema: **UNË, FAMILJA IME DHE MIQTË E MI**
 Gjithsej: **25 orë**

Rezultatet e të nxënit:
 Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të përshëndetet në komunikimin formal dhe joformal;
2. të njihet me dikë dhe të prezantojë veten, familjen e tij të ngushtë dhe miqtë e tij në një bisedë joformale duke i përdorur përemrat vetorë, përemrat dëftorë *ky/kjo*, përemrat pyetës *kush* dhe *çfarë* dhe kohë e tashme të përemrit *jam*;
3. të dallojë, të lexojë dhe të shkruajë shkronjat e shtypit të alfabetit (latin) të gjuhës shqipe;
4. të kuptojë domethënien e një numri të caktuar fjalësh dhe t'i përdorë ato në kontekst përkatës në një bisedë joformale (miq, anëtarë të familjes)

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):	Standardet për vlerësim:
<p>a) Funksionet gjuhësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Përshëndetja dhe njohja: Tungjatjeta / Përshëndetje / Mirëdita, Mirëmëngjesi / Mirëmbërëma / Ditën e mire / Natën e mirë / Mirupafshim <i>A: Përshëndetje, si quhesh?</i> <i>B: Unë quhem Toni / Ena.</i> ● Prezantimi i miqve: <i>Kjo është Ana, ka 10 vjet.</i> <i>Ky është Gorani, ka 9 vjet.</i> ● Prezantimi i familjes: <i>Kush është kjo / ky – Kjo është... (nëna ime, motra ime, gjyshja ime) / Ky është...(babai im, vëllai im,</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ● Njeh informacionin nga teksti i dëgjuar lidhur me përshëndetjen dhe njohjen. ● Dallon dhe përdor shprehjet e përshëndetjes. ● Njihet dhe prezantohet duke përdorur trajtat e foljes <i>jam</i>. ● I prezanton anëtarët e familjes së vet të ngushtë dhe miqtë në mënyrë joformale në një thënie të shkurtër ose në një dialog që përmban trajta të foljes <i>jam</i> në kohën e tashme dhe përemra dëftorë. ● Merr pjesë në një dialog të shkurtër për të prezantuar miqtë, anëtarët e familjes, fqinjët, duke ndërtuar fjali të shkurtra që përmbajnë përemra vetorë, përemrin dëftor <i>ky / kjo</i> dhe trajtat e foljes <i>jam</i> në kohën e tashme. ● U përgjigjet pyetjeve të shkurtra e të thjeshta për veten, familjen dhe miqtë në një kontekst përkatës.

<i>gjyshi im)</i>	
<p>b) Njësitë leksikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Familja dhe miqtë: <i>djalë, vajzë, vëlla, motër, kushëri, nip;</i> ● Mbiemrat: <i>i madh, i mirë, i bukur, i vjetër, i ri, i gjatë, i shkurtër.</i> ● Parafjalët e vendit: <i>nga, në.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ● Emërton anëtarët e ngushtë dhe të gjerë të familjes dhe miqtë. ● Përshkruan anëtarët e familjes duke përdorur mbiemra cilësorë.
<p>c) Ndërtimet gramatikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Përemrat vetorë: <i>unë, ti ai/ajo, ne, ju, ata/ato</i> ● Përemrat dëftorë: <i>ky/kjo</i> është ● Emrat e përgjithshëm në gjinë e në numër përkatës ● Përemrat pronorë: <i>im, yt, ynë, juaj</i> ● Trajtat e foljes <i>jam</i> në kohën e tashme ● Trajtat e foljes <i>kam</i> në kohën e tashme 	<ul style="list-style-type: none"> ● Ndërton fjali të shkurtra me përemrat vetorë dhe përemrat dëftorë <i>ky</i> dhe <i>kjo</i> gojarisht dhe me shkrim. ● Dallon përemrat pronorë në komunikim. ● Përdor emrin në gjininë dhe numrin e duhur. ● Përdor trajtat e foljes <i>jam</i> në kohën e tashme në vetën dhe numrin e duhur. ● Përdor trajtat e foljes <i>kam</i> në kohën e tashme në vetën dhe numrin e duhur. ● Përdor trajtat e foljes <i>jam</i> në kohën e tashme në fjali pohore dhe mohore.
<p>ç) Të shkruarit me alfabetin latin të shqipes (shkronjat e shtypit, shkronjat e vogla, shkronjat e mëdha, alfabeti)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Dallon dhe shkruan shkronjat e shtypit (të vogla dhe të mëdha). ● Përdor alfabetin (latin) e shtypit të gjuhës shqipe për të shkruar emrin e tij dhe për të kopjuar dialogë të shkurtër. ● Shkruan fjalë të thjeshta.
<p>d) Të lexuarit (drejtshqiptimi i zanoreve <i>y, ë</i> dhe i bashkëtingëlloreve <i>th, dh, rr, l, ll</i>; Përdorimi i drejtë i togjeve të zanoreve <i>ua, ue, ie, ye</i> dhe i bashkëtingëlloreve <i>mb, nd, ng, ngj; pl, bl, fl, shq</i>)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● I shqipton drejt zanoret <i>y, ë</i> dhe togjet e zanoreve <i>ua, ue, ie, ye</i>. ● I shqipton drejt bashkëtingëlloret <i>th, dh, rr, l, ll</i> dhe togjet e bashkëtingëlloreve <i>mb, nd, ng, ngj, pl, bl, fl, shq</i>. ● Lexon fjalë, fjali, tekste të shkruara me shkronjat e mësuara të alfabetit të gjuhës shqipe.
<p>dh) Përmbajtjet ndërkulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Ditëlindja, urimi i ditëlindjes, dhurata 	<ul style="list-style-type: none"> ● Njeh shprehjet e urimit të ditëlindjes. ● Përdor shprehje/fraza që tashmë i ka përvetësuar për të uruar ditëlindjen.
Shembuj të aktiviteteve:	

- Nxënësit përshëndeten në çifte.
- Nxënësit luajnë role – simulime të dialogëve të shkurtër gjatë një takimi: *si jeni/si je/jam mirë*.
- Nxënësit luajnë role pas dëgjimit të një modeli dhe prezantohen duke përdorur përemrat vetorë dhe trajtat e foljes *jam*.
- Mësimdhënësi tregon një foto ose imazh elektronik të shokut/anëtarit të familjes së tij dhe e prezanton atë. (*Kjo është Ana, ajo është nga Tetova. Kjo është motra ime, ajo është e vogël*) dhe më pas nxënësit luajnë role duke u prezantuar sipas parimit të njëjtë.
- Nxënësit sjellin disa foto nga shtëpia dhe prezantojnë një anëtar të familjes.
- Nxënësit në çifte përshkruajnë shokët dhe më pas i paraqesin në një vizatim.
- Nxënësit bëjnë një strip me dy/tre vizatime të vogla që ilustronjë një dialog të njohjes/prezantimit.
- Nxënësit përpilojnë një dialog të shkurtër autentik bazuar në modelin e dhënë dhe dialogun e realizojnë para gjithë klasës.
- Nxënësit ndahen në grupe të vogla, ulen në një rreth dhe luajnë "Pyetje dhe përgjigje" - *Kush është ky/Ky është...*
- Nxënësve u jepen karta me disa fotografi, ilustrime të familjes, miqve të ulur së bashku. Nxënësit i emërtojnë dhe i përshkruajnë (*Kjo është një vajzë, ajo është e vogël, ky është një djalë, ai është i madh*).
- Nxënësit dëgjojnë një shembull fjalie: *Kjo është gjyshja ime, ky është gjyshi im. Kjo është familja ime*. Më pas ata i përsërisin shembujt duke përdorur përemrat pronorë.
- Nxënësit përdorin karta ku paraqiten një djalë, një vajzë, djem e vajza... I përsërisin trajtat e njëjësit dhe të shumësit të emrave.
- Nxënësit dëgjojnë pohime duke përdorur foljen *jam* në kohën e tashme dhe luajnë lojën e saktë/ e pasaktë duke u shprehur për secilin pohim (*Emri yt është Bojan - e pasaktë; emri yt është Fatma – e saktë*).
- Nxënësit riprodhojnë sipas modelit *Çfarë ke ti? Unë kamÇfarë ka Sanella? Sanella ka...*
- Nxënësit ndahen në çifte, njëri thotë një fjali pohore dhe tjetri e ndryshon atë në mohore duke përdorur format e foljes *jam*. (*Ai është nga Manastiri. Ai nuk është nga Manastiri, ai është nga Resnja*).
- Nxënësit në çift luajnë *me shkronjën, me shkronjën...* Ata zgjedhin së bashku një shkronjë dhe pastaj njëri pas tjetrit i thonë objektet dhe njerëzit emërtimet e të cilëve fillojnë me shkronjën e zgjedhur.
- Mësimdhënësi/ja krijon një zar prej kartoni dhe shkruan një zanore (*ë, y*) ose një tog zanoresh (*ua, ue, ie, ye*) në secilën anë të kutisë. Nxënësit hedhin zarin duke e rrotulluar atë derisa i bie njëra nga zanoret/togjet e zanoreve dhe e shqipton atë fuqishëm.
- Mësimdhënësi/ja shkruan në dërrasë të zezë/tabelë fjalë që fillojnë me bashkëtingëlloret: *th, dh, rr, l, ll* (p.sh: *thikë, dhuratë, rroba, lule, llambë etj.*) ndërsa nxënësit shqiptojnë drejt fjalët, me kujdes të veçantë të shkronjat e para të fjalëve.
- Nxënësit, në grupe, marrin fleta të palosura ku janë shkruar fjalë që përmbajnë togjet e bashkëtingëlloreve: *mb, nd, ng, ngj, pl, bl, fl, shq* (p.sh. *mbesë, ndërtesë, ngadalë, ngjyrë, pluhur, bleta, shqiponja etj.*), më pas ata i lexojnë fjalët duke i shqiptuar drejt togjet e bashkëtingëlloreve.
- Nxënësit, në çifte, nga shkronjat e dhëna në renditje të përzier formojnë fjalë të thjeshta. Pasi i formojnë fjalët, i lexojnë drejt.

- Nxënësit në një fletë pune lidhin një fjalë me një ilustrim përkatës.
- Nxënësit dëgjojnë një këngë ditëlindjeje (p.sh. *Shumë urime për ty*) dhe bëjnë një kartolinë urimi.
- Nxënësit luajnë një lojë - *ditëlindja*, këndojnë këngë dhe fryjnë qiri, duke e thënë me zë të lartë urimin/dhuratën e dëshiruar të ditëlindjes.

Tema: **SHKOLLA DHE MJEDISI JETËSOR**

Gjithsej: **25 orë**

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të kuptojë domethënien e njësive leksikore të dëgjua që lidhen me shkollën dhe mjedisin jetësor (natyrën dhe kafshët) për t'i përdorur ato në një kontekst përkatës.
2. të numërojë deri në 10 në gjuhën shqipe.
3. të përshkruajë shkollën dhe mjedisin jetësor me modele fjalish të përvetësuara.
4. të zhvillojnë bisedë, dialogë të shkurtër rreth shkollës dhe mjeteve shkollore duke përdorur njësi përkatëse leksikore dhe përemrat vetorë, përemrat dëftorë *ky/kjo*, përemrat pyetës *kush* dhe *çfarë*, kohën e tashme të foljeve *jam* dhe *kam*.
5. të lexojë dhe të kuptojë thënie të shkurtra dhe/ose dialogë të shkurtër që lidhen me shkollën dhe mjedisin jetësor.
6. të përdorë drejt alfabetin (latin) të shqipes dhe shenjat e pikësimit kur ndërton fjali të shkurtra dhe/ose dialogë të shkurtër.
7. të kuptojë domethënien e një numri të caktuar fjalësh nga tema *shkolla* dhe t'i përdorë ato në një kontekst përkatës.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):

Standardet për vlerësim:

a) Funksionet gjuhësore:

- Përshëndetjet formale në shkollë dhe përdorimi i vetës së dytë shumës në komunikimin formal (*Mirëdita, si jeni? Më lejoni t'ju pyes, t'ju them*)
- Prezantimi dhe përshkrimi i mjedisit dhe shkollës, klasës, mjeteve shkollore, kafshëve dhe mjedisit duke përdorur fjalë përkatëse (emra, mbiemra dhe përemra)
- Numërimi deri në 10
- ndërtimi i fjalive/thënieve të shkurtra për natyrën dhe motin (ka diell, bie shi, fryn erë)

- Dallon dhe përdor shprehjet e përshëndetjes duke përdorur vetën e dytë shumës në komunikim.
- Njeh informacionin e një teksti të dëgjuar që lidhet me shkollën dhe mjedisin (natyrën dhe kafshët).
- Tregon dhe përshkruan mjetet shkollore.
- Tregon dhe përshkruan objektet e klasës.
- Numëron në kontekste të ndryshme.
- Merr pjesë në një dialog të shkurtër duke ndërtuar fjali të shkurtra që i përmbajnë njësitë e mësuara leksikore.
- Harton thënie për natyrën/dukuritë natyrore (dielli ngroh, bie shi, fryn erë).

<p>b) Njësitë leksikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkolla, klasa, libri, fletorja, lapsi, goma, banka, karrigia, dërrasa e zezë/tabela, markeri, hameri • Vendet: rruga, parku, shtëpia, ferma • Kafshët: kafshët e përkëdhelura dhe kafshët shtëpiake • Numrat nga 1 deri 10 	<ul style="list-style-type: none"> • Emërton objektet në mjedisin e shkollës së tij dhe mjetet shkollore. • Dallon kuptimin e fjalëve (emrave) që kryejnë funksionin e rrethanorit të vendit: rruga, shtëpia, parku, ferma. • Emërton dhe tregon kafshët e përkëdhelura dhe kafshët shtëpiake. • I thotë numrat deri në 10 në kontekste të ndryshme.
<p>c) Ndërtimet gramatikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përemrat vetorë: <i>unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato</i> • Përemrat dëftorë: <i>ky/kjo</i> • Përemrat pyetës: <i>kush</i> dhe <i>çfarë</i> • Emrat – emrat e përgjithshëm, kategoria e gjinisë dhe e numrit (kafshët, shkolla, inventari i shkollës dhe mjetet shkollore, vende nga mjedisi) • Mbiemrat cilësorë (<i>i madh, i vogël, i shkurtër, i gjatë, i mirë, i bukur, i kuq, i verdhë, i gjelbër, i kaltër, i bardhë, i zi</i>) • Përemrat pronorë (<i>im, ime, e mi, e mia, yt, jote, e tu, e tua, ynë, jonë, juaj.</i>) • Foljet (përdorimi i foljeve në mënyrën dëftore: <i>lexoj, jetoj, ha, pi</i>) • Foljet <i>jam</i> dhe <i>kam</i> në kohën e tashme • Fjalja, fjalia e thjeshtë 	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor përemrat (vetorë dhe dëftorë) gjatë komunikimit dhe prezantimit. • Përdor emra nga njësitë e mësuara në kategorinë e duhur gramatikore të gjinisë dhe kategorinë gramatikore të numrit. • Përshkruan duke përdorur mbiemra përkatës. • Harton thënie të shkurtra duke i përdorur drejt përemrat pronorë. • Përdor folje në vetën dhe numrin e duhur në kohën e tashme. • Ndërton fjali të shkurtra me foljet <i>jam</i> dhe <i>kam</i> në vetën dhe numrin përkatës në kohën e tashme. • U përgjigjet pyetjeve të thjeshta që lidhen me mjedisin jetësor nëpërmjet zbatimit të drejtë të ndërtimeve gramatikore dhe modeleve bazë të fjalive. • Riprodhon fjali dhe thënie të thjeshta.
<p>ç) Të shkruarit dhe të lexuarit (shkronja e madhe, pikëpyetja, pikëçuditja)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Lexon fjalë, fjali, dialogë me temë shkolla dhe mjedisi jetësor me shqiptim dhe theks të drejtë. • Shkruan fjali dhe dialogë të shkurtër, duke e përdorur shkronjën e madhe dhe shenjat e pikësimit (pikën, pikëçuditjen dhe pikëpyetjen).

<p>d) Përmbajtjet ndërkulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gëzuar Ditën e Alfabetit, Gëzuar Bajramin • Gëzuar Vitin e Ri, pema e Vitit të Ri, urimet dhe stolisja 	<ul style="list-style-type: none"> • Njeh specifikat që lidhen me festat që tashmë i ka përvetësuar dhe dallimet kulturore: kuptimi i Ditës së Alfabetit, festimi i Bajramit dhe i Vitit të Ri. • Përdor shprehje/fraza që tashmë i ka përvetësuar për urimin e Ditës së Alfabetit, të Bajramit dhe të Vitit të Ri.
--	---

<p>Shembuj të aktiviteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit simulojnë situata reale nga jeta shkollore, për shembull hyrja në zyrën e mësimit për të kërkuar një mësues: <i>Më falni, e kërkojmë mësuesin/sen...mund ta thërrisni?</i> • Nxënësit dëgjojnë materiale për kafshët e përkëdhelura dhe për ato shtëpiake dhe më pas i thonë njësitë leksikore. Pastaj mësuesi u jep ilustrime në të cilat ata i lidhin njësitë leksikore që i kanë dëgjuar me ilustrimin përkatës dhe i thonë përsërisht ato njësi leksikore. • Nxënësit ndahen në grupe. Në secilin grup ka elementë të mjeteve shkollore, i numërojnë, i tregojnë dhe i përshkruajnë: <i>ky është një laps i gjelbër, kjo është një gomë e kaltër...</i> • Nxënësit marrin karta me fjalët që i dinë, i lexojnë dhe shkruajnë nga një mbiemër në kuadër të njësitë leksikore të mësuara. • Nxënësit në çift e përshkruajnë klasën dhe më pas bëjnë një vizatim për të. • Nxënësit numërojnë elemente të klasës: 5 banka, 10 karrige, 2 tabela/dërrasa të zeza. • Mësuesi përgatit ilustrime/material elektronik dhe nxënësit formulojnë thënie të shkurtra sipas tyre: <i>Unë jam në park. Ai është në rrugë. Vesa është në shtëpi, kurse Merti është në fermë.</i> • Nxënësit shikojnë foto të një ferme. I përgjigjen pyetjes: <i>Çfarë është kjo?</i> Dhe i prezantojnë kafshët, emrat e të cilave i kanë mësuar. • Nxënësit luajnë lojën <i>“Marinar, si është moti”</i> dhe përdorin shprehjet e motit. • Nxënësit thonë fjali në të cilat e plotësojnë fjalën - <i>kafshë/kafshë e përkëdhelur</i> duke përdorur foljen <i>ka</i> në kohën e tashme (<i>Unë kam një qen / mace</i>). • Nxënësit i përshkruajnë kafshët e tyre të përkëdhelura duke përdorur fotografi dhe përdorin përemra, emra dhe mbiemra në formë të duhur. • Nxënësit shkruajnë sipas diktimit dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. • Nxënësit hartojnë dhe lexojnë dialogë të shkurtër për temën <i>shkolla</i>. • Nxënësit dëgjojnë një këngë për Bajramin dhe mësuesi/ja bën një prezantim vizual të gatimeve tradicionale për këtë festë. Pas shikimit të prezantimit, nxënësit i përsërisht fjalët që lidhen me festën. • Nxënësit dëgjojnë një këngë për alfabetin e gjuhës shqipe dhe thonë nga një fjalë për secilën shkronjë.

Tema: **KOHA E LIRË DHE PUSHIMET**

Gjithsej: **22 orë**

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të përdorë fjalë për t'u shprehur me mirësjellje, për të kërkuar falje, për t'u lutur, për të konfirmuar dhe për të refuzuar.
2. të kuptojë domethënien e njësive leksikore të dëgjua për tema që lidhen me kohën e lirë, mjetet e transportit, ditët e javës dhe muajt e vitit dhe t'i përdorë ato në një kontekst përkatës.
3. të përshkruajë pushimet e veta dhe kohën e vet të lirë duke përdorur folje të përshtatshme për të përshkruar aktivitetet.
4. t'i përdorë përemrat, emrat dhe mbiemrat në gjininë dhe numrin e duhur, si dhe foljet në vetën dhe numrin e duhur në kohën e tashme.
5. të lexojë dhe të kuptojë thënie dhe fjali me fjali nga temat e mësuara.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):

Standardet për vlerësim:

a) Funksionet gjuhësore:

- Komunikimi dhe të shprehurit me mirësjellje (kërkimi i faljes, të luturat, konfirmimi dhe refuzimi)
- Të shprehurit lidhur me kohën e lirë dhe aktivitetet
- Emërtimi i ditëve të javës, stinëve, muajve

- Identifikon dhe thotë forma gjuhësore të të shprehurit me mirësjellje përmes një konteksti të dëgjuar.
- Merr pjesë në dialogë në të cilët përdoret kërkimi i faljes, falënderimi, lutja.
- Merr pjesë në dialog duke parashtruar pyetje dhe/ose duke u përgjigjur pyetjeve të shkurtra lidhur me dëshirat dhe interesat personale.
- I përshkruan aktivitetet që i bën në kohën e lirë duke përdorur fjali të shkurtra.
- I emërton ditët e javës dhe muajt e vitit.
- I emërton stinë të vitit.

b) Njësitë leksikore:

- Koha e lirë dhe pushimet
- Ditët e javës
- Stinë/muajt e vitit
- Mjetet e transportit (makina/vetura, autobusi,

- Kupton domethënien e kohës së lirë dhe të pushimeve.
- Ndërton fjali të shkurtra ku përfshihen ditët e javës në korrelacion me ndonjë aktivitet të caktuar shkollor ose aktivitet të lirë (*Të hënën notoj*).
- I identifikon dhe i dallon njësitë e parapara leksikore që emërtojnë mjete transporti.

aeroplani, anija, biçikleta)	
<p>c) Ndërtimet gramatikore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përemrat vetorë: <i>unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato</i> • Përemra dëftorë: <i>ky/kjo</i> • Përemrat pyetës: <i>kush, cili/cila, cilët/cilat</i> dhe <i>çfarë</i> • Emrat – emrat e përgjithshëm, kategoria e gjinisë dhe e numrit (stinët e vitit, muajt e vitit, ditët e javës, pushimet, mjetet e transportit) • Mbiemrat cilësorë (<i>i madh, i vogël, i shkurtër, i gjatë, i mirë, i bukur, i kuq, i verdhë, i gjelbër, i kaltër, i bardhë, i zi</i>) • Përemrat pronorë (<i>im, ime, e mi, e mia, yt, jote, e tu, e tua, ynë, jonë, juaj</i>). • Foljet (folje në mënyrën dëftore: <i>dua, shkoj, udhëtoj, notoj, vrapoj, lexoj, luaj, këndoj</i>) • Ndajfoljet e kohës: <i>sot, tani</i> 	<ul style="list-style-type: none"> • I zbaton përemrat në vetën dhe numrin e duhur. • I përdor emrat në gjininë dhe numrin e duhur, duke u përshtatur një mbiemër përkatës. • Pyet dhe përgjigjet për stinët e vitit dhe pushimet. (<i>Në cilën stinë jemi? Në pranverë.</i>) • Riprodhon thënie të shkurtra që lidhen me aktivitete të një stine të caktuar të vitit dhe me mjete të caktuara të transportit, duke përdorur folje të përshtatshme nga ana kuptimore, në vetë dhe në numër të duhur. • Harton thënie të shkurtra me njësitë e parapara leksikore në kategori përkatëse gramatikore.
ç) Të lexuarit me të kuptuar	<ul style="list-style-type: none"> • U përgjigjet pyetjeve të thjeshta rreth një teksti të lexuar.
<p>d) Përmbajtjet ndërkulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dita e Verës, Gëzuar Ditën e Verës, verore për në dorë • Pushimet verore/ Rruga e mbarë, pushime të këndshme 	<ul style="list-style-type: none"> • Uron pushime të këndshme verore. • Uron rrugë të mbarë. • Riprodhon dhe i thotë në mënyrë të pavarur njësitë e përvetësuara leksikore për tema që lidhen me festat. • Uron Ditën e Verës.
<p>Shembuj të aktiviteteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit në çift luajnë role duke lutur dhe kërkuar falje, duke konfirmuar dhe refuzuar. (<i>Ju lutem, më falni, po, dua; jo, nuk dua</i>). • Nxënësit bëjnë dialogë: <i>Çfarë bën në kohën e lirë? Lexoj / luaj në instrument / luaj / udhëtoj.</i> • Nxënësit përdorin fjali të shkurtra për t'iu përgjigjur pyetjes: <i>Çfarë bëj të dielën?</i> • Nxënësit luajnë një lojë: <i>Cila ditë e javës është / cili muaj është?</i> • Nxënësit e shkruajnë stinën e tyre të preferuar të pushimeve në një copë letre, i vendosin fletët në një grumbull dhe pastaj secili tërheq një 	

fletë dhe thotë një ngjyrë dhe një mbiemër për stinën që i ka rënë.

- Nxënësve u jepen fotografi të mjeteve të transportit. Mësimdhënësi/ja tregon ilustrime ose materiale elektronike të destinacioneve të njohura të udhëtimit. Nxënësit tregojnë se me cilat mjete të transportit mund të arrihet atje.
- Nxënësit plotësojnë pohimet sipas ilustrimeve të dhëna: *Në kohën e lirë dua të (udhëtoj/notoj/vrapoj/lexoj).*
- Nxënësit ndahen në grupe dhe ulen në një rreth. I thonë ditët e javës një nga një derisa të bëhet një gabim në radhitje, pastaj vazhdon grupi tjetër.
- Nxënësit dëgjojnë një këngë shqipe për fëmijë me temë nga stinët e vitit. Pasi e dëgjojnë, e riprodhojnë materialin leksikor me ndihmën dhe pyetjet e mësimdhënësit/ses.
- Nxënësve u jepen karta me emrin e muajve dhe të stinëve të vitit, i radhisin muajt nëpër stinët përkatëse.
- Nxënësit bëjnë një kalendar me karta, duke renditur ditët e javës dhe pastaj edhe muajt.
- Nxënësit lidhin emrin e një stine me një ilustrim të një aktiviteti me karakteristikë të asaj stine.
- Nxënësit i plotësojnë fjalitë me foljet përkatëse që jepen si opsion për të plotësuar vendin e zbrazur sipas një ilustrimi. (*Agimi..... këndon/ec. Ana.....lexon/këndon*).
- Nxënësit lexojnë një tekst të shkurtër me fjalë dhe ndërtime gjuhësore që tashmë i kanë mësuar dhe u përgjigjen pyetjeve rreth tij.
- Nxënësit luajnë role dhe krijojnë një dialog të shkurtër – përcjellja i një shoku në pushime.
- Nxënësit ndjekin një prezantim për festimin/zakonet e Bajramit/Pashkëve (falja e namazit të Bajramit, dreka e Bajramit, vizita e familjarëve). Pas shikimit të prezantimit, nxënësit përsërisin fjalët që lidhen me festën.
- Nxënësit bëjnë një vizatim me një verore si simbol i Ditës së Verës dhe e përshkruajnë atë (sipas gjatësisë dhe ngjyrës).

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen nëpërmjet kyçjes së të gjithë nxënësve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave /përmbajtjeve/ koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlihin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve bëhet në bazë të standardeve të dhëna të vlerësimit, duke vënë në dukje anët pozitive për përparimin e nxënësve në përvetësimin e gjuhës dhe jo anët negative të mangësive. Duke pasur parasysh se në klasën e katërt, në lëndën e gjuhës shqipe për nxënësit e komuniteteve të tjera që mësojnë në gjuhën maqedonase dhe turke i zotërojnë të katër aftësitë gjuhësore: Të dëgjuarit me të kuptuar të përmbajtjes, të lexuarit fillestar me të kuptuar të përmbajtjes, të folurit (interaksion dhe prodhim në të folur) dhe të shkruarit fillestar (interaksion dhe prodhim në të shkruar), mësimdhënësi/ja ndjek dhe vlerëson:

- përgjigjet e dhëna me gojë pyetjeve të mësimdhënësit/ses ose të nxënësve të tjerë dhe pjesëmarrjen e tyre në dialogë të shkurtër duke përdorur fjalorin e përvetësuar;
- reagimet verbale dhe joverbale pas dëgjimit të një thënieje;
- të lexuarit dhe të kuptuarit e thënieve të shkurtra, dialogëve të shkurtër dhe vjershave të shkurtra;
- të shkruarit saktë të fjalëve, fjalive të shkurtra dhe dialogëve të shkurtër, si dhe shkrimi sipas modelit tingullor - diktimit;
- punimet e nxënësve (afishet, ilustrimet, ditarët);
- detyrat e shtëpisë.

Pas përfundimit të çdo teme, nxënësit marrin vlerësim sumativ përshkrues sipas standardeve të arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ përdoret në periudha të caktuara të vitit shkollor dhe lidhet me përfundimin e temave të veçanta, me tremujorin, me gjysmëvjetorin dhe përfundon me notë numerike në fund të vitit shkollor.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti shkollor 2023/2024	
Institucioni/bartës i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit	Биро за развој на образованието
<p>Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i arsimit dhe shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe si lëndë zgjedhore për klasën VI</i></p> <p>Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19 и 229/20) министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по <i>Албански јазик како изборен предмет за VI одделение</i></p>	<p>nr. 08-6438/1 viti 13.6.2023</p> <p>бр. 08-6438/1 13.6.2023 година</p>	<p>Министер за образование и наука, Doc. Dr. Jeton Shaqiri</p> <hr/>